



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.2002/2 prot.,

Datë 16.08.2023

FORMULAR PËR PUBLIKIM
LIDHUR ME ARSYET E SKUALIFIKIMIT NË RASTIN E ANKESAVE PËR
VENDIMIN E VLERËSIMIT/KLASIFIKIMIT PËRFUNDIMTAR

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “DAJTI PARK 2007” SHPK në procedurën e prokurimit “*Proçedurë e Hapur*” me Nr. REF-73947-06-29-2023, me objekt loti 2: “*Blerje bordura provizore varri*” me fond limit 7,703,675.10 Lekë, pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar në datën 21.07.2023 nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Shërbimeve Funerale.

Ankimues: Operatori Ekonomik “DAJTI PARK 2007” SHPK.
Adresa: *Rruga “Bardhok Biba”, Pallati TREMA, Hyrja C, Tiranë*

Autoriteti Kontraktor: Agjencia e Shërbimeve Funerale
Adresa: *Rr. “Durrësit”, nr.132, Tiranë*

Në datën 15.08.2023 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është paraqitur në mënyrë shkresore ankesa me nr. 2002, protokolluar me datë 15.08.2023 e operatorit ekonomik “DAJTI PARK 2007” SHPK për procedurën e prokurimit “*Proçedurë e Hapur*” me Nr. REF-73947-06-29-2023, me objekt loti 2: “*Blerje bordura provizore varri*” me fond limit 7,703,675.10 Lekë, pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar në datën 21.07.2023 nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Shërbimeve Funerale.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës së sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “DAJTI PARK 2007” SHPK.

Bazuar në nenin 112, pika 4, gërma “b” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: “Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon:

b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar;”.

Komisioni i Prokurimit Publik do të publikojë arsyet e skualifikimit që operatori ekonomik “DAJTI PARK 2007” SHPK kundërshton me anë të ankesës me nr. 2002 prot., datë 15.08.2023.

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime mbi arsyen e skualifikimit si më poshtë vijon:

Arsyet e skualifikimit:

Në DST në pikën 2.3 të Kapacitetit teknik përcaktohet se:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, **në një vlerë jo më të vogël se 30% (vlera 2,311,102.53 lekë) e fondit limit të lotit 2/shumatores së loteve për të cilat konkuron (vlera 6,518,404.71 lekë).**

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- Operatorët ekonomikë si dëshmi për përvojën e mëparshme duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe **sasitë e mallrave të furnizuara.**

- Për sa më sipër, operatori ekonomik nuk e plotëson këtë kriter ,pasi si dëshmi për përvojën e ngjashme ka paraqitur tre kontrata me objekt “Ndërtim i rrugës Kongresi i Dibrës”, “Ndërtim i rrugëve Pavaresia, Pashko Vasa, Pishtaret e Demokracise, Mustafa Qemal Ataturku, Athina, Dubai” të lidhura me Bashkinë e Kamzës dhe “Ndërtim i rrugëve të brendshme në Ibë të sipërme dhe rikualifikim i shesheve”.

Kontratat e paraqitura rezultojnë kontrata me objekt të ndryshëm nga objekti i prokurimit “Mall”, Loti 2: “Blerje bordure provizore varri”.

Publikuar në rregjistrin e ankesave më datë 16.08.2023.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Nënkryetar
Fiorent Zguro